



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë-
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship
and Trade

RAPORT VJETOR 2023

Implementimi i Programit për
Eliminimin e Barrierave në Tregti Sipas Neneve 34 – 36 TFBE (2021 – 2025)

LISTA E SHKURTESAVE

AKS – Agjencia Kosovare e Standardizimit
AMK – Agjencia e Metrologjisë së Kosovës
BE – Bashkimi Evropian
CEFTA – Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me Evropën Qendrore
CEN – Komiteti Evropian për Standardizim
CENELEC – Komiteti Evropian për Standardizimin Elektroteknik
DI - DIC – Departamenti i Industrisë – Divizioni për Infrastrukturë të Cilësisë
ETSI – Instituti Evropian i Standardeve të Telekomunikacionit
GJED – Gjykata Evropiane e Drejtësisë
KE – Komisioni Evropian
KNjN– Klauzola e njohjes së ndërsjellë
LLM – Lëvizja e Lirë e Mallrave
MBPZHR – Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
ME – Ministria e Ekonomisë
MINT – Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
MMPHI – Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MPBAP – Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike
MSA – Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
MSH - Ministria e Shëndetësisë
PKZMSA – Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit
SHA – Shtetet Anëtare
TBT – Barrierat Teknike në Tregti
TFBE – Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) ka dërguar në Qeverinë e Republikës së Kosovës (QRK) Programin për Eliminimin e Barrierave në Tregti (2021-2025) sipas neneve 34-36 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE). Programi për Eliminimin e Barrierave në Tregti është miratuar me 22 Qershor 2021 nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 22/16.

Programi për Eliminimin e Barrierave në Tregti sipas neneve 34 - 36 TFBE si bazë ligjore ka nenin 80 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) me titull “*Standardizimi, metrologjia, akreditimi dhe vlerësimi i konformitetit*” dhe kërkesën për Republikën e Kosovës që të ndërmarrë masat e nevojshme në mënyrë që gradualisht të arrihet përputhshmëria me legjislacionin horizontal dhe sektorial të BE-së për sigurinë e produkteve si dhe të sjellë infrastrukturën e cilësisë, si standardizimi, metrologjia, akreditimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit sipas standardeve evropiane”.

Në koordinim me Qeverinë e Republikës së Kosovës, MINT vazhdon punën si institucion përgjegjës për ekzekutimin e të gjitha detyrimeve koordinuese në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave dhe për zbatimin e legjislacionit në fushën e pa harmonizuar (fushë e cila nuk mbulohet nga rregullat e harmonizuara të BE-së), duke bashkërenduar aktivitetet me ministritë tjera (ME, MMPHI, MBPZHR, MPBAP, MSH) dhe agjencitë respektive.

Autoritetet rregullatore sipas fushëveprimtarisë së tyre kanë vazhduar punën në implementimin e “Programit për Eliminimin e Barrierave në Tregti” për vitin e dyte duke respektuar afatet për shqyrtim të akteve ligjore kundrejt barrierave sipas neneve 34-36 të TFBE.

Bazuar në rekomandimet e Raportit Vjetor për vitin 2022 është adresuar kërkesa për forcimin e kapaciteteve dhe zgjerimin e grupit punues ndërministror (*për çështjet kryesore/ legjislacionin e produktit në Kapitullin 1*) të themeluar me Vendimin Nr.22/16, Dt.22.06.2021 nga Qeveria së Republikës së Kosovës. MINT pas marrjes së propozimeve nga ministritë e linjës dhe agjencitë tjera ka dërguar në Qeveri draftin për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Nr.22/16, Dt.22.06.2021. Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin është miratuar Dt.09.11.2022, Nr.06/106, ku tani pjesë e grupit punues janë përfaqësues të të gjitha institucioneve të cilat përfaqsojnë legjislacionin i cili është pjesë e Programit për Eliminimin e Barrierave në Tregti dhe koordinimin e metutjeshëm ndërinstitutional për lëvizjen e lirë të mallrave.

Sipas aktiviteteve të deritanishme të planifikuara dhe të realizuara është kryer dhe do të kryhet shqyrtimi i akteve si në vijim:

- Gjatë vitit 2022 janë shqyrtuar 10 akte ligjore,
- Gjatë vitit 2023 janë shqyrtuar 32 akte ligjore të planifikuara për vitin 202,
- Deri në fund të viteve 2024 dhe 2025 planifikohen të shqyrtohen 81 akte ligjore.

Pas shqyrtimit të 32 akteve ligjore, gjatë vitit 2023, ka rezultuar se disa akte kanë dispozita që përbëjnë barriera të pajustificuara për tregtinë dhe se këto akte ligjore duhet të ndryshohen dhe

plotësohen ose shfuqizohen. Nga Shtojca 1 e Programit janë shqyrtuar 27 akte , nga të cilat trembëdhjetë (13) akte të shqyrtuara nuk përmbajnë barrierë për tregtinë dhe nga Shtojca 2 janë shqyrtuar pesë (5) e Programit nga të cilat tri (3) akte nuk përmbajnë barrierë për tregtinë.

Gjatë punës dhe diskutimit me autoritetet rregullatore për situatën ekzistuese ligjore dhe planet e tyre për miratimin e amendamenteve në legjislacionin primar të vlefshëm, u konstatua se një sërë ligjesh do të ndryshohen/zëvendësohen me ligje të reja dhe që të gjitha aktet nënligjore do të ridraftohen. Si rrjedhojë, u dakordua që shqyrtimi i detajuar i legjislacionit të miratuar sipas këtyre ligjeve do të bëhet pas miratimit të akteve ligjore të reja/ndryshuara i cili pritet të bëhet kryesisht në gjatë viteve 2024 dhe 2025.

Gjatë vitit 2023, prioritet i është dhënë kryesisht legjislacionit sekondar i cili derivon nga ligjet primare të cilat janë pjesë e Aneksit 1 dhe 2 të Programit për Eliminimin e Barrierave në Tregti.

Bazuar në rekomandimet e Raportit Vjetor për vitin 2022, ministritë kompetente dhe autoritetet e tjera rregullatore, të koordinuara nga MINT, deri në fund të Nëntorit 2023 do t'i raportojnë sërish Qeverisë së Republikës së Kosovës për gjetjet e akteve ligjore të shqyrtuara me afatin kohor të përcaktuar për shqyrtimin e mëtejshëm të detajuar të akteve ligjore të mbuluara nga ky Program si dhe masat korrigjuese të propozuara për eliminimin e barrierave të pajustificuara në tregti.

Raporti vjetor për vitin 2023 bashkon aktet ligjore të përfshira në Shtojcat 1 dhe 2 të Programit në një Shtojcë integrale të raportit i cili duhet të organizohet sipas fushave të produkteve (*p.sh. kimikatet dhe automjetet*) dhe jo nga ato teknike ose natyrë jo teknike të akteve juridike, e cila do të përditësohet vazhdimisht duke reflektuar zhvillimin e statusit të tyre.

Ministritë kompetente dhe autoritetet e tjera rregullatore, gjatë përgatitjes së akteve ligjore të reja ose të ndryshuara në lidhje me tregtinë e produkteve, do të marrin parasysh komentet dhe rekomandimet e dhëna në kuadër të asistencës teknike për shqyrtimin e detajuar të legjislacionit që mund të shkaktojë barrierë të pajustificuara në tregti.

II. ADOPTIMI I PROGRAMIT NGA QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË 2021

Implementimi i Programit për eliminimin e barrierave në tregti kërkon koordinim ndërmjet autoriteteve rregullatore për shqyrtimin e rregulloreve për produktet jo ushqimore (industriale) si dhe produktet ushqimore, ndërveprueshmëri dhe një bashkëpunim ndër sektorial ndërmjet autoriteteve rregullatore të cilat janë subjekti i Programit, për marrjen e masave për eliminimin e barrierave të pajustificuara në tregti të indentifikuara gjatë procesit të shqyrtimit dhe po ashtu edhe për përgatitjen e raportit vjetor. Gjithashtu, zbatimi i vazhdueshëm i Programit kërkon dhe do të kërkojë në vitet në vijim një punë të mirëkoordinuar ndërmjet autoriteteve rregullatore dhe zbatuese.

MINT është përgjegjës për udhëheqjen dhe kryerjen e të gjitha detyrave në lidhje me koordinimin në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave dhe për zbatimin e legjislacionit në fushën e pa harmonizuar (fushë e cila nuk mbulohet nga rregullat e harmonizuara të BE-së). Përveç

MINT-it, një rol të drejtpërdrejtë rregullator për Qeverinë e Republikës së Kosovës, e kanë edhe ministritë tjera dhe agjencitë respektive sipas fusheveprimtarisë së tyre:

- Ministrinë e Ekonomisë (ME),
- Ministrinë e Shëndetësisë (MSH),
- Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI);
- Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike (MPBAP),
- Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR),
- Agjencioni Rregullator për Komunikim Elektronike dhe Postare- ARKEP
- Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale - KPMM
- Agjencioni Kosovar për Pajisje dhe Produkte Medicinale - AKPPM (MSH)
- Agjencia e Udhqimit dhe Veterinarisë - AUV (MBPZHR)
- Agjencioni për Menaxhimin e Emergjencave - AME (MPBAP)
- Agjencioni i Metrologjisë së Kosovës - AMK (MINT).

MINT përmes grupit punues ndërministror për koordinimin e punës së të gjitha ministrive kompetente në lidhje me legjislacionin teknik, është përgjegjëse për zbatimin e detyrave që dalin nga lëvizja e lirë e mallrave në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara nga Republika e Kosovës, i themeluar me Vendimin Nr.22/16, Dt.22.06.2021 dhe Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin është miratuar Dt.09.11.2022, Nr.06/106 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të vazhdojë punën në zbatimin e detyrave sipas Vendimit të lartcekur referuar pikës:

3.2 Rregullat në lidhje me miratimin dhe zbatimin e rregulloreve teknike në fushat që nuk janë rregulluar me rregullat e BE-së për harmonizim; dhe

- pikës 4 dhe 4.1 të Vendimit si në vijim:

4. Për realizimin e detyrave në kuadër të pikës 3.2 MINT koordinon punën me autoritetet rregullatore kompetente për të implementuar “Programin 2021-2025 për eliminimin e barrierave në tregti”, përmes:

4.1. Rishikimit të vazhdueshëm të legjislacionit teknik dhe jo-teknik të pa- harmonizuar, i cili mund të përmbajë pengesa të pajustificuara në tregti, dhe eliminimit të pengesave të tilla përmes masave korrigjuese të përshtatshme.

Përveç ministrive të linjës, të cilat janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e legjislacionit për grupe të ndryshme për produktet, vlen të përmendet edhe Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut, pasi është autoriteti më i rëndësishëm për realizimin e një roli i cili kërkon mbikëqyrjen e produkteve në treg të cilat janë gjithashtu në kuadër të rregullave të pa harmonizuara dhe parimeve ligjore të zbatueshme. Inspektoratet kompetente të ministrive të tjera, si Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Ministria e Ekonomisë (ME) dhe Ministria e Shëndetësisë (MSH) si dhe Dogana e Kosovës do të kontribuojnë në inputet e kërkuara kryesisht përmes Trupit Koordinues për Mbikëqyrje të Tregut (TKMT). Gjithashtu një rol të rëndësishëm në këtë proces ka edhe Agjencia Kosovare e Standardizimit e cila po vazhdon mbështetjen për ministritë dhe agjencitë me adoptimin

kryesisht të standardeve të harmonizuara të cilat janë pjesë esenciale për zbatimin e legjislacionit për lëvizjen e lirë të mallrave.

Programi përbëhet nga pesë aktivitete kryesore:

1. Rishikimi i legjislacionit teknik të pa harmonizuar, i cili mund të përmbajë “masa me efekt ekuivalent” dhe eliminimi i barrierave të pajustificuara me një masë korrigjuese përkatëse.

2. Rishikimi i legjislacionit kombëtar jo-teknik, i cili përmes marrëveshjeve të shitjes dhe kufizimeve për përdorim mund të krijojë pengesa të pajustificuara për tregtinë, dhe heqja e pengesave të pajustificuara me një masë korrigjuese të përshtatshme.

Pasi që nenet 34-36 aplikohen për fushën e pa harmonizuar të produkteve, pjesë e shqyrtimit të detajuar është i gjithë legjislacioni kombëtar që ndërlidhet me kushtet e tregtimit të produkteve me qëllim të eliminimit edhe të barrierave që vijnë si rezultat i një transpozimi jo korrekt të legjislacionit evropian në atë kombëtar. Bazuar në rekomandimin e Raportit Vjetor 2023, pika 3, janë bashkuar aktet ligjore të përfshira në shtojcat 1 dhe 2 të raportit të vitit 2022, në një shtojcë integrale të raportit për vitin 2023, i cili duhet të organizohet sipas **fushave të produkteve** dhe jo nga natyra teknike ose jo teknike e akteve juridike.

3. Aktivitetet e mëtutjeshme të MINT – DI/DIC, AKS dhe ministrive përkatëse të linjës për përmbushjen e detyrimeve të rregulluara me dispozitat e Direktivës (BE) 2015/1535 dhe Rregullores (BE) 1025/2012 të cilat janë transpozuar në legjislacion kombëtar, përkatësisht në *“Rregulloren (QRK) nr. 28/2018 për mënyrën e notifikimit mbi rregulloret teknike, procedurat e vlerësimit të konformitetit dhe standardet”*.

4. Krijimi i pikave të kontaktit të produktit si qendër informacioni për palët e interesuara sipas dispozitave të Rregullores (BE) 2019/515 për Njohjen Reciproke të Mallrave të Tregtuara Ligjërisht në një Shtet Tjetër Anëtar.

5. Përgatitjet e autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut për zbatimin e mbikëqyrjes së tregut sipas parimeve dhe dispozitave të Rregullores (BE) 2019/515 për Njohjen Reciproke të Mallrave të Tregtuara Ligjërisht në një Shtet Tjetër Anëtar.

Me Vendimin Nr.20/89, Dt. 20 Korrik 2022, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Raportin Vjetor 2022 - Implementimi i Programit për eliminimin e barrierave në tregti sipas neneve 34 – 36 TFEU (2021 – 2025)”, me pikat kryesore si në vijim:

1. Ministritë kompetente dhe autoritetet e tjera rregullatore, të koordinuara nga MINT, do t'i raportojnë sërish Qeverisë së Republikës së Kosovës deri në fund të nëntorit 2023 për gjetjet e akteve ligjore të shqyrtuara dhe për afatin kohor të përcaktuar për shqyrtimin e mëtejshëm të detajuar të akteve ligjore të mbuluara nga ky Program si dhe masat korrigjuese të propozuara për heqjen e barrierave të pajustificuara në tregti.

2. Raporti Vjetor 2023 do të bashkojë aktet ligjore të përfshira në shtojcat 1 dhe 2 të këtij raporti në një shtojcë integrale të raportit i cili duhet të organizohet sipas fushave të produkteve (p.sh. kimikatet dhe automjetet) dhe jo nga natyra teknike ose jo teknike e akteve juridike.

3. Ministritë kompetente dhe autoritetet e tjera rregullatore, gjatë përgatitjes së akteve ligjore të reja ose të ndryshuara në lidhje me tregtinë e produkteve, do të marrin parasysh komentet

dhe rekomandimet e dhëna në kuadër të asistencës teknike për shqyrtimin e detajuar të legjislacionit që mund të shkaktojë barriera të pajustificuara në tregti.

4. Forcimi i kapaciteteve dhe zgjerimi i grupit punues ndërministror (për çështjet kryesore/ legjislacionin e produktit në Kapitullin 1) i themeluar me Vendimin Nr.22/16, Dt.22.06.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

III. ZBATIMI I PROGRAMIT NË VITIN E DYTË

Për periudhën e raportimit nga viti 2022 kur është aprovuar Raporti Vjetor 2022 - Implementimi i Programit për eliminimin e barrierave në tregti sipas neneve 34 – 36 TFEU (2021 – 2025)”, janë realizuar aktivitetet si në vijim:

1. Tërheqja e legjislacionit teknik të pa harmonizuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës(Shtojcat 1)

Minsitritë përkatëse dhe Autoritetet rregullatore gjatë vitit 2023 kanë ndërmarrë veprimet si në vijim:

- Rregullore (MTI) Nr. 01/2014 për Kërkesat Themelore dhe Vlerësimin e Konformitetit të Pajisjeve Elektrike Shtëpiake për Ngrirje, Frigoriferëve dhe Kombinimet e Tyre, në Lidhje me Kërkesat e Eficiencës së Energjisë është shfuqizuar me vendimin e Ministres së MINT të datës 29.12.2023 me nr protokoli 7730/01.
- Ministria e Ekonomisë do të përgatitë bazën ligjore për hartimin e akteve nënligjore të cilat e rregullojnë këtë fushë.
- Rregullore (MTI) Nr.01/2013 për Kërkesat Teknike për Pllakat e Drurit është shfuqizuar me vendimin e Ministres së MINT të datës 29.12.2023 me nr protokoli 7729/01.
- Udhëzim Administrativ (MMPH) Nr. 02/2019 për Eksport, Import dhe Kalimin Tranzit të Mbeturinave, do të shfuqizohet me hyrjen në fuqi të Projekt-Udhëzim Administrativ MMPHI Nr.XX për Përcaktimin e Kushteve, Kriteve dhe Procedurave për Lëshimin e Lejes për Import, Eksport dhe Kalim Tranzit të Mbeturinave, i cili është hartuar në përputhje me Rregulloren e BE 1013/2006 dhe pritet të miratohet deri në fund të 2023.
- Udhëzim Administrativ (MI) Nr. 02/2018 për Përcaktimin e Kushteve dhe Procedurave për Homologim të Mjeteve Rrugore - Janë shfuqizuar dispozitat të cilat përbëjnë shkelje të neneve 34-36 TFEU, me Ligjin 08/L-004 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.05/L-132 për Automjete
- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 08/2019 për Përcaktimin e Pajisjeve Mbrojtëse, Teknike dhe Mjeteve për Zjarrfikje dhe Shpëtim, do të rishikohet dhe rekomandimet do

të adresohen pas miratimit të ligjit të ri për Mbrojtje nga Zjarri dhe Ligjit për zjarfikje dhe shpëtim të cilat janë hartuar dhe pritet të procedohen për miratim.

- Rregullore (QRK) Nr.28/2013 për Aditivët Ushqimor - Ligji për Nr. 08/L-120 për USHQIM ka hyrë në fuqi më 12 gusht 2022. Rregullorja e EC 1333/2008 për aditivët ushqimor do të transpozohet gjatë vitit 2024 nga MBPZHR.

2. Rishikimi i legjislacionit jo teknik të Kosovës i cili mund të përmbajë barriera të pajustificuara në tregti (Shtojca 2)

Minsitritë përkatëse dhe Autoritetet rregullatore gjatë vitit 2023 kanë ndermarrë veprimet si në vijim:

- Ligji Nr. 04/L- 156 për Kontrollin e Duhanit, Ligji Nr. 04/L-041 për Prodhimin, Grumbullimin, Përpunimin dhe Tregtimin e Duhanit dhe Udhëzim Administrativ (MINT) nr. 02/2021 për Përcaktimin e Kushteve dhe Kriterëve për Subjektet që Merren me Tregtimin e Duhanit dhe Produkteve të tij, janë duke u rishikuar, është duke u hartuar Ligji i ri për duhanin dhe transponon direktivën e BE-së 2014/40/EU dhe pritet të finalizohet deri në fund të vitit 2023.
- Udhëzim Administrativ (MTI) Nr. 09 /2020 Për Kontrollin dhe Cilësinë e Karburanteve të Lëngëta të Naftës është shfuqizuar pjesërisht dhe është kthyer në zbatim UA 01/2017 për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës me Vendimin Nr.Prot.3580 e dt.07.05.2021. Pjesa e cila e rregullon “ Shënjinin e karburanteve të lëngëta të naftës dhe monitorimin e tyre ” është ende në fuqi.

3. Shqyrtimi Akteve Kombëtare Ligjore kundrejt Neneve 34-36 të TFBE-së të cilat mund të përmbajë pengesa të pajustificuara në tregti, nga Shtojcat 1 dhe 2 të Programit

Sipas rekomandimeve përkatëse nga Raporti Vjetor 2022, pika 3, në këtë raport vjetor janë bashkuar dy anekset në një të vetëm të integruar.

3.1. Shqyrtimi i legjislacionit nga Shtojca 1 i cili mund të përmbajë pengesa të pajustificuara në tregti

MINT në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe agjencitë respektive, me asistencën e ekspertëve të angazhuar nga Projekti “LUX-Dev” gjatë vitit 2023 ka kryer shqyrtimin e detajuar kundrejt neneve 34-36 të TFBE, të akteve ligjore të mëposhtme:

- Rregullore (MTI) Nr. 01/2017 për pajtueshmërinë elektromagnetike;
- Rregullore teknike (MTI) Nr. 06/2018 për pajisjet elektrike të dizajnuara për përdorim brenda kufijve të caktuar të tensionit;
- Rregullore (MTI) Nr. 03/2017 për Sigurinë e Ashensorëve;

- Rregullore (MTI) Nr. 05/2018 për Sigurinë e Ashensorëve në Përdorim;
- Udhëzim Administrativ (MTI) Nr. 08/2022 për përcaktimin e kushteve për vendosjen e betonit të gatshëm në treg;
- Udhëzim Administrativ (MTI) Nr. 08/2020 për caktimin e kushteve për vendosjen e agregateve dhe mbushësve për beton në treg;
- Rregullore (MTI) Nr. 04/2012 për produktet e qelqit të kristaltë;
- Rregullore (MTI) Nr. 03/2016 në etiketimin e mbathjeve;
- Rregullore (MTI) Nr. 02/2020 për etalonët shtetëror të matjes dhe materialet referente;
- Rregullore (MTI) Nr. 06/2016 për instrumentet matëse;
- Udhëzim Administrativ (MI) Nr. 10/2023 për kontrollimin teknik të Automjeteve;
- Rregullore nr.40 për shfrytëzimin e brezeve të radio frekuencave për të cilat nuk kërkohet autorizim individual dhe kushtet e përcaktuara teknike të përdorimit të radio pajisjeve në këto breze (Ref. Nr.Prot. 046/B/18);
- Rregullore (MZHE) Nr.05/2017 për ndërtimin, instalimin dhe mbikëqyrjen e infrastrukturës së komunikimeve elektronike (Ref.Nr.Prot. 05/2017);
- Rregullore teknike Nr.31 për Radio Pajisjet (Ref. Nr.Prot. 032/B/17);
- Rregullore për licencimin e stacioneve të avionëve (Ref. Nr. Prot. 007/B/12);
- Rregullore (MEA) Nr. 03/2020 për sigurinë e pajisjeve nën presion;
- Rregullore (MZHE) Nr. 02/2019 mbi ekzaminimin e kontrollit dhe vlerësimin e pajisjeve teknike të presionit të sigurisë në shfrytëzim;
- Rregullore Nr. 02/2012 për administrimin e mbeturinave minerare;
- Rregullore Nr. 06/2011 për sigurinë e minierave;
- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr.23/2012 për normat teknike për furnizimin e mjeteve motorike me derivate të naftës, deponimin dhe toçitjen e derivateve të naftës në pikat e shitjes me pakicë;
- Rregullorja (QRK) Nr. 24/2012 mbi normat teknike për mbrojtjen e ndërtesave të larta nga zjarri;
- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 08/2018 mbi normat teknike për mbrojtjen e depove nga zjarri dhe shpërthimet;
- Udhëzim Administrativ (MPB) nr. 01/2020 për normat teknike për mbrojtjen nga zjarri të infrastrukturës elektroenergjetike dhe pajisjeve;
- Udhëzim Administrativ (MBPZHR) – Nr. 06/2017 për kushtet e veçanta të evidentimit, kontrollit dhe shenjëzimit të miellit, i cili vendoset në qarkullim të lire në tregun e Republikës së Kosovës;
- Udhëzim Administrativ (MBPZHR) Nr.07/2016 për ndalimin e përdorimit të substancave të caktuara në blegtori që kanë veprim hormonal ose tireostatik dhe beta agonistëve.
- Rregullore (MEPTINIS) Nr. 02/2020 Për Sigurinë e Makinerive
- Udhëzim Administrativ Nr. 09/2012 për Etiketimin e Pajisjeve që Shfrytëzojnë Energji

Analiza e detajuar e gjithë akteve ligjore është paraqitur në një dokument të veçantë, e cila është diskutuar dhe dakorduar me të gjitha ministritë e linjës dhe agjencitë respektive.

Dokumentet me gjetjet nga procesi i shqyrtimit iu dërguan ministrive të linjës dhe autoriteteve të tjera rregullatore për të vendosur mbi masat e nevojshme korrigjuese pasi u identifikuan pengesa të mundshme të pajustificuara për tregtinë.

Në vijim është paraqit një përmbledhje e gjetjeve nga shqyrtimi i detajuar i këtyre akteve:

- **Rregullore (MTI) Nr. 01/2017 për pajtueshmërinë elektromagnetike**

Kërkesat lidhur me detyrimin e përdorimit të gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës për detajet e kontaktit të prodhuesit dhe importuesit si dhe prezumimi i konformitetit ndaj standardeve të harmonizuara kombëtare, përbëjnë barriera të pajustificuara si pasojë e gabimeve në transpozimin e *acquis* të BE-së.

Është propozuar rishikimi vetëm i dispozitave përkatëse dhe harmonizimim me Ligjin Nr.06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit.

- **Rregullore (MTI) Nr. 06/2018 për pajisjet elektrike të dizajnuara për përdorim brenda kufijve të caktuar të tensionit;**

Kërkesat lidhur me detyrimin e përdorimit të gjuhës kombëtare dhe kufizim i prezumimit të konformitetit ndaj standardeve të harmonizuara kombëtare, përbëjnë masa/barriera të pajustificuara.

Rekomandohet rishikim i dispozitave përkatëse.

- **Rregullore (MTI) Nr. 03/2017 për Sigurinë e Ashensorëve;**

Nga analiza e detajuar rezultoi që referenca vetëm në standardet e harmonizuara kombëtare krijon barrierë për produktet e importuara të BE-së.

Rekomandohet rishikimi i nenit përkatës dhe harmonizim me Ligjin Nr.06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit.

- **Rregullore (MTI) Nr. 05/2018 për Sigurinë e Ashensorëve në Përdorim;**

Nuk u identifikua asnjë dispozitë në shkelje të nenit 34-36 të TFBE.

- **Udhëzim Administrativ (MTI) Nr. 08/2022 për përcaktimin e kushteve për vendosjen e betonit të gatshëm në treg;**

Nuk u identifikua asnjë dispozitë në shkelje të nenit 34-36 të TFBE.

- **Udhëzim Administrativ (MTI) Nr. 08/2020 për caktimin e kushteve për vendosjen e agregateve dhe mbushësve për beton në treg;**

Nuk u identifikua asnjë dispozitë në shkelje të nenit 34-36 të TFBE.

- **Rregullore (MTI) Nr. 04/2012 për produktet e qelqit të kristaltë;**

Nga analiza e detajuar rezultuan pasaktësi në etiketimin e qelqit të kristaltë që mund të krijojë barriera të pajustificuara në importe.

Propozohet rishikimi i Aneksit të Rregullores.

- **Rregullore (MTI) Nr. 03/2016 në etiketimin e mbathjeve;**

Nga analiza rezultoi që kufizimi i fushës së zbatimit të kësaj rregullore, krijon mundësinë e barrierave të pajustificuara për këto produkte.

Propozohet riformulimi i nenit përkatës.

- **Rregullore (MTI) Nr. 02/2020 për etalonët shtetëror të matjes dhe materialet referente;**

Nuk u identifikua asnjë dispozitë në shkelje të nenit 34-36 të TFBE.

- **Rregullore (MTI) Nr. 06/2016 për instrumentet matëse;**

Nga shqyrtimi i detajuar i rregullores rezultoi që kërkesa e përdorimit të gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës lidhur me informacionin dhe dokumentacionin që duhet të siguroj prodhuesi ose importuesi në rast të një kërkesë nga Inspektorati i Tregut, është transpozim jo krejtësisht korrekt i acquis të BE-së. Po kështu sipas arsytimit më lartë edhe referenca tek standardet harmonizuara kombëtare janë barriera të pajustificuara si pasojë e transpozimit jo korrekt të acquis BE-së.

Rekomandohet rishikim i dispozitave përkatëse.

- **Udhëzim Administrativ (MI) Nr. 10/2023 për kontrollimin teknik të Automjeteve;**

Nuk u identifikua asnjë dispozitë në shkelje të nenit 34-36 të TFBE.

- **Rregullore nr.40 për shfrytëzimin e brezeve të radio frekuencave për të cilat nuk kërkohet autorizim individual dhe kushtet e përcaktuara teknike të përdorimit të radio pajisjeve në këto breze (Ref. Nr.Prot. 046/B/18);**

Nuk u identifikua asnjë dispozitë në shkelje të nenit 34-36 të TFBE.

- **Rregullore (MZHE) Nr.05/2017 për ndërtimin, instalimin dhe mbikëqyrjen e infrastrukturës së komunikimeve elektronike (Ref.Nr.Prot. 05/2017);**

Nuk u identifikua asnjë dispozitë në shkelje të nenit 34-36 të TFBE

- **Rregullore Teknike Nr.31 për Radio Pajisjet (Ref. Nr.Prot. 032/B/17);**

Nga shqyrtimi rezultoi që duhen rishikuar dispozitat që kanë të bëjnë me detyrimin e përdorimit të gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës në rastin e detajeve të kontaktit, informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar nga Inspektorati i Tregut, si barriera për shkak të transpozimit jo shumë korrekt.

Rekomandohet rishikim i dispozitave përkatëse.

- **Rregullore për licencimin e stacioneve të avionëve (Ref. Nr. Prot. 007/B/12);**

Nuk u identifikua asnjë dispozitë në shkelje të nenit 34-36 të TFBE.

- **Rregullore (MEA) Nr. 03/2020 për sigurinë e pajisjeve nën presion;**

Barrierat lidhur me detyrimin e përdorimit të gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës për detajet e kontaktit, regjistrimet dhe korrespondenca e prodhuesit me trupën e vlerësimit të konformitetit si dhe prezumimi vetëm në referencë të standardeve të harmonizuara janë si pasoje e transpozimit jo të saktë.

Rekomndohet të rishikohen vetëm dispozitat përkatëse të cilat rregullojnë këto çështje.

- **Rregullore (MZHE) Nr. 02/2019 për kontrollin, shqyrtimin dhe vlerësimin e sigurisë teknike të pajisjeve nën presion në shfrytëzim;**

Nga shqyrtimi i rregullores rezultoi se ky akt përmbanë dispozita të cilat përbëjnë pengesa dhe barrierë të pajustificuara për vendosjen në shfrytëzim të këtyre pajisjeve në kundërshtim me Direktivën 2014/68/EU. Kërkesa të tilla janë edhe në Ligjin nr. 06/L-031 për pajisjet nën presion.

Duhet të bëhet rishikimi i dispozitave në ligjin bazë dhe në këtë rregullore.

- **Rregullore (MZHE) Nr. 02/2012 për administrimin e mbeturinave minerare**

Nuk u identifikua asnjë dispozitë në shkelje të nenit 34-36 të TFBE.

- **Rregullore (MZHE) Nr. 06/2011 për sigurinë e minierave;**

Nuk u identifikua asnjë dispozitë në shkelje të nenit 34-36 të TFBE.

- **Udhëzim Administrativ (MPB) Nr.23/2012 për normat teknike për furnizimin e mjeteve motorike me derivate të naftës, deponimin dhe toçitjen e derivateve të naftës në pikat e shitjes me pakicë.**

Përdorimi i detyrueshëm i standardeve “Ex” dhe të tjera është barrierë që vjen si rezultat i transpozimit jo korrekt të acquis të BE-së.

Propozohet rishikim i dispozitave përkatëse.

- **Rregullorja (QRK) Nr. 24/2012 mbi normat teknike për mbrojtjen e ndërtesave të larta nga zjarri;**

Nuk u identifikua asnjë dispozitë në shkelje të nenit 34-36 të TFBE.

- **Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 08/2018 mbi normat teknike për mbrojtjen e depove nga zjarri dhe shpërthimet;**

Përdorimi i detyrueshëm i standardeve përbënë barriera të pajustificuara për tregtinë.

Propozohet riformulim i dispozitës përkatëse.

- **Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 01/2020 për normat teknike për mbrojtjen nga zjarri të infrastrukturës elektroenergjetike dhe pajisjeve;**

Nuk u identifikua asnjë dispozitë në shkelje të nenit 34-36 të TFBE.

- **Udhëzim Administrativ (MBPZHR) – Nr. 06/2017 për kushtet e veçanta të evidentimit, kontrollit dhe shenjzimit të miellit, i cili vendoset në qarkullim të lire në tregun e Republikës së Kosovës;**

Në këtë udhëzim janë parashikuar testime të detyrueshme përpara vendosjes në treg, kërkesa të detyrueshme për paketimin e miellit, sisteme licencimi për importuesit e miellit, të cilat janë në kundërshtim me dispozitat e përkatëse të acquis të BE-së.

Propozohet shfuqizim i Udhëzimit Administrativ.

- **Udhëzim Administrativ (MBPZHR) Nr.07/2016 për ndalimin e përdorimit të substancave të caktuara në blegtori që kanë veprim hormonal ose tireostatik dhe beta agonistëve.**

Nuk u identifikua asnjë dispozitë në shkelje të nenit 34-36 të TFBE.

- **Rregullore (MEPTINIS) Nr. 02/2020 Për Sigurinë e Makinerive**

Transpozim jo korrekt i disa pikave të cilat nderlidhen me përmbajtjen e deklaratës së konformitetit dhe kufizim i prezumimit të konformitetit ndaj standardeve të harmonizuara kombëtare konsiderohen si masa me efekt ekuivalent të pajustificuar.

Rekomandohet rishikimit/amandamentim të dispozitave përkatëse.

- **Udhëzim Administrativ Nr. 09/2012 për Etiketimin e Pajisjeve që Shfrytëzojnë Energji**

Mungesë e transpozimit të Rregullores së re 2017/1369/BE. Masa me efekt ekuivalent dhe kufizimet sasiore të pajustificuara lidhur me vendosjen e etiketës dhe fletën e të dhënave dhe përdorimin e gjuhës zyrtare.

Rekomandohet shfuqizim i gjithë aktit ligjor dhe transpozimi i Rregullores së re 2017/1369/BE.

3.2. Shqyrtimi i legjislacionit nga Shtojca 2 i cili mund të përmbajë pengesa të pajustificuara në tregti

Ministritë e linjës dhe autoritetet e tjera rregullatore kanë rishikuar dhe përditësuar listën e akteve ligjore të përfshira në Shtojcën 2 të Programit, duke zëvendësuar disa prej tyre me projekt-akte të reja të cilat tashmë janë përgatitur sipas planit që do të miratohet deri në fund të vitit **2023**, duke synuar që të reflektojnë mbi zhvillimet e reja dhe të përditësuara në përputhje me rrethanat. Kjo do të thotë se aktet ligjore që do të shfuqizohen në vitin **2023** (p.sh. Ligji Nr. 2004/18 për Tregtinë e Brendshme, Ligji Nr. 04/L-022 për Përdorimin Civil të Eksplozivëve) **u zëvendësuan me ligje të reja që do të rregullojnë fushat e njëjta (Projektligji për Tregtinë e Brendshme, Projektligji për Lëndët Plasëse).**

Në këtë mënyrë, MINT dhe ministritë e linjës kanë siguruar përdorimin optimal të resurseve të asistencës së ekspertit të projektit “LUX-Dev” dhe kanë realizuar në këtë mënyrë kontrollin ex-ante, d.m.th., shqyrtimin e përputhshmërisë me nenet 34-36 TFBE-së të legjislacionit të ri të Kosovës i cili planifikohet miratohet. Propozohet që në të ardhmen të përdoret një qasje e tillë edhe për aktet tjera ligjore që janë të përcaktuara në Shtojcën I ose Shtojcën II sapo këto të zëvendësohen me projekt-aktet që do t'i shfuqizojnë (ose t'i ndryshojnë), veçanërisht kur teksti i projekt akteve të tilla të jetë në fazën paraprake të përgatitjes. Një qasje e tillë garanton edhe qëndrueshmërinë e zbatimit të Programit dhe parandalon paraqitjen e pengesave të pajustificuara në tregti në legjislacionin e Kosovës (kontrolli ex-ante i përputhshmërisë me nenet 34-36 të TFBE-së).

Shqyrtimi kundrejt neneve 34-36 të TFBE-së i pesë (5) akteve ligjore nga Shtojca 2 e Programit i bërë deri në fund të majit 2023 është realizuar nga MINT me asistencën e ekspertëve të projektit “LUX-Dev” dhe përfshin shqyrtimin e detajuar të akteve ligjore (projektakteve) të mëposhtme:

- **Ligji Nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit (duke përfshirë tekstin e veçantë të Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit),**
- **Ligji Nr. 02/L-128 për Barnat Narkotike, Substancat Psikotrope dhe Prekursorë**
- **Projektligji për Tregtinë e Brendshme (në vend të Ligjit Nr. 2004/18 për Tregtinë e Brendshme),**
- **Projektligji për Lëndët Plasëse (në vend të Ligjit Nr. 04/L-022 për Përdorimin Civil të Eksplozivëve),**
- **Rregullorja (QRK) nr. 18/2016 për Regjistrimin dhe Aprovimin e Operatorëve të Biznesit me Ushqim**

Analiza e detajuar e tri akteve ligjore në fuqi dhe e tri projektakteve ligjore është paraqitur në dokumente të veçanta. Dokumentet me gjetjet nga procesi i shqyrtimit iu dërguan ministrive të linjës dhe autoriteteve të tjera rregullatore për të vendosur mbi masat e nevojshme korrigjuese pasi u identifikuan pengesa të mundshme të pajustificuara për tregtinë.

- **Ligji Nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit**

Kërkesat që u identifikuan dhe duhet të hiqen i referohen: përdorimit të detyrueshëm të gjuhës kombëtare; deklaracionit të vendit të origjinës/kërkesave për paraqitjen e mallrave

(paraqitja, etiketimi), si masa me efekt të njëjtë dhe që janë të ndaluara nga neni 34 i TFBE-së.

Nenet që duhet të ndryshohen për të hequr pengesat e pajustificuara ndaj tregtisë (kërkesat gjuhësore) janë nenet 16 paragrafi 2 dhe 19 paragrafi 2 të cilat do të parandalojnë që ky ligj të rezultojë në një barrë shtesë për produktet me origjinë nga vendet e tjera (SHA të BE-së), ndërsa në mënyrë më të saktë lejojnë mundësinë e përdorimit të mjeteve të tjera për informimin e konsumatorëve, siç janë dizajnet, simbolet dhe piktogramet. Nga ana tjetër, ndryshimet e propozuara të nenit 18 paragrafi 2 (prezantimi, etiketimi) në të ardhmen duhet të zbatohet në baza vullnetare (shënimi i vendit të origjinës) që do të rezultojë në lehtësimin e tregtimit në Kosovë të mallrave të ngjashme të prodhuara në një shtet anëtar të BE-së, duke mos pasur efekt, siç është tani, për të inkurajuar konsumatorët që të blejnë produkte kombëtare në dëm të produkteve ekuivalente nga këto vende importuese të BE-së.

Kufizimi i fundit dhe më i ashpër që duhet anuluar është neni 16 paragrafi 8 lidhur me kërkesën për paraqitjen e flamurit të vendit të origjinës së produktit, e cila gjithashtu duhet të rezultojë me shfuqizimin e rregullave më të detajuara të gjetura në Udhëzimin Administrativ (MTI) Nr. 01/2019 për Caktimin e Formës, Përmbajtjes dhe Përdorimit të Flamurit mbi Origjinën e Produktit.

Së fundi, sapo të bëhet shqyrtimi i Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit duhet theksuar se në të ardhmen e afërt versionin i konsoliduar i neneve 76 deri 83 duhet të harmonizohen me Direktivën e re 2019/771/BE (dhe paralelisht me 2019/770/BE të ndërlidhur ngushtë) në mënyrë që të rregullohen aspektet e reja për shitjen e mallrave dhe garancitë e ndërlidhura të cilat do të përmbajnë rregulla të reja të përshtatura nga BE, gjithashtu për “mallra me elemente digjitale ose të ndërlidhura me shërbimet digjitale”.

- Ligji nr. 02/L-128 për Barnat Narkotike, Substancat Psikotrope dhe Prekursorë

Ligji nuk është plotësisht në përputhje me acquis të BE-së që është në fuqi. Dispozitat e ligjit janë të vitit 2008 kur këto kërkonin pajtueshmëri, krahas konventave ndërkombëtare, me Rregulloren 273/2004.

Mos-harmonizimi konsiderohet si masë e efektit ekuivalent pasi rregullat e tregtimit ndryshojnë nga rregullat që duhet të transpozohen plotësisht.

Prandaj, dispozitat lëndore të ligjit duhet të harmonizohen me Rregulloren e re (BE) Nr. 1258/2013, e cila ndryshon Rregulloren 273/2004) (dhe Rregulloren (BE) Nr. 1259/2013, e cila ndryshon Rregulloren 111/2005) për të rregulluar në mënyrë adekuate kontrollin dhe monitorimin e prodhimit, qarkullimin e shitjes me shumicë dhe pakicë, importin, eksportin, kalimin transit, transportin, blerjen, furnizimin, shitjen, posedimin, konsumimin, përdorimin e këtyre substancave, duke mos penguar parimet e lëvizjes së lirë të mallrave.

- Projektligji për Tregtinë e Brendshme

Në projektligj nuk janë identifikuar pengesa të pajustificuara për tregtinë.

Projektligji është në përputhje me nenet 34-36 të TFBE-së, gjë e cila është veçanërisht e rëndësishme pasi ky ligj është ligj sistematik i cili përmban rregulla horizontale për sa i përket detyrimit të çdo tregtari që njëherë dëshiron të angazhohet në tregtinë e mallrave.

Vëmendje e veçantë gjatë shqyrtimit iu kushtua për të siguruar që ligji të mos përmbajë kufizime të cilat mund të kenë formën e procedurave të autorizimit/dispozitave kombëtare në lidhje me inspektimet dhe kontrollet/kriteret për procedurat e autoriteteve kompetente/kufizimin e përdorimit/ndalimin kombëtar i specifikave, produktet/substancat për shqyrtimin e dispozitave.

- Projektligji për Lëndët Plasëse

Në projektligj nuk janë identifikuar pengesa të pajustificuara për tregtinë.

Projektligji është në përputhje me nenet 34-36 të TFBE-së, pasi që transponon Direktivën 2014/28/BE për vënien në dispozicion në treg dhe mbikëqyrjen e eksplozivëve për përdorim civil dhe Direktivën 2013/29/BE për vënien në dispozicion në për tregun e lëndëve piroteknike. Si i tillë, ai eliminon mospërputhjet me *acquis* në fuqi, të dëshmuara në rregullat e gjetura në Ligjin aktual Nr. 04/L-022 për Përdorimin Civil të Eksplozivëve (i cili do të shfuqizohet pas miratimit të ligjit të).

- Rregullorja (QRK) nr. 18/2016 për Regjistrimin dhe Aprovimin e Operatorëve të Biznesit me Ushqim

Në rregullore nuk janë identifikuar pengesa të pajustificuara për tregtinë.

Mirëpo, meqenëse në ndërkohë është miratuar Ligji i ri Nr. 08/L-120 për Ushqimin (korrik 2022), i cili është bazë i këtij akti nënligjor, Ministra e përkatëse, duhet të siguroj me kohë miratimin e Rregullores së re për Operatorët e Biznesit me Ushqim në harmoni të plotë me ligjin e ri. Në përputhje me nenin 42 të ligjit të ri, afati për rregulloren e re është gushti i vitit 2023, i cili nëse nuk respektohet do të çonte në marrjen e një mase me efekt ekuivalent d.m.th procedurat e autorizimit (kriteret që nuk janë objektive, transparente, të njohura paraprakisht për ndërmarrjet ekzistuese dhe mund të shihen si bazë për vendimmarrje të mundshme arbitrare të autoriteteve kompetente dhe/ose krijon baza për pasiguri juridike për shkak të mospërputhjes ndërmjet ligjit të ri dhe akteve nënligjore të vjetra).

4. Përmbushja e detyrimeve nga Rregullorja (QRK) Nr. 28/2018 për Mënyrën e Notifikimit mbi Rregulloret Teknike, Procedurat për Vlerësimin e Konformitetit dhe Standardet

Rregullorja e cila është në fuqi nga viti 2018 për nevojat e sistemit të notifikimit të CEFTA-s për draftet e rregulloreve të reja teknike që planifikohen të miratohen në shtetet anëtare ka për qëllim që përmes sistemit/platformes elektronike t'u japë mundësi për të komentuar draftet e reja dhe për të propozuar ndryshime që do të parandalonin krijimin e pengesave të reja të pajustificuara për tregtinë të gjitha vendeve të CEFTAS.

MINT (përmes Pikës së Kontaktit në DIC) ka njoftuar Odën Ekonomike në Republikën e Kosovës pas pranimi të notifikimit për të shpërndarë informacionin tek anëtarët e tyre për të dhënë komente mbi legjislacionin e ardhshëm të vendeve të CEFTA-s që mund të cenojnë planet e eksportit të operatorëve individualë të biznesit.

Gjatë vitin 2023, platforma online e CEFTAs për notifikime, është lëshuar në funksion pas 2 vitete rishikimi dhe ka filluar procesi i noifikimit të akteve ligjore/nënligjore. Gjatë këtij viti Kosova ka notifikuar përmes platformës 4 drafte të akteve që janë harutar dhe ka pranuar 14 notifikime nga shtett tjera anëtare të CEFTAs.

Në të ardhmen rregullorja do të përdoret edhe në kuadër të Organizatës Botërore të Tregtisë dhe në kuadrin e Bashkimit Evropian.

5. Përgatitja e bazës ligjore për pikat e kontaktit për produkte si qendër informacioni për palët e interesuara sipas dispozitave të Rregullores (BE) 2019/515 për Njohjen Reciproke të Mallrave të Tregtuara Ligjërish në Një Shtet tjetër Anëtar

Grupi i punës i krijuar në bazë të ligjit Nr. 06/L-41 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit, në Mars të vitit 2022 ka përgatitur një “Plan veprimi për zbatimin e këtyre Rregulloreve:

- Rregullore (BE) për Mbikëqyrjen e Tregut dhe Përputhshmërinë e Produkteve (2019/1020), dhe
- Rregullore (BE) për Njohjen Reciproke të Mallrave (2019/515).

Ndër të tjera, plani i veprimit parashikon përgatitjen e një ligji të ri primar (rekomandohet "Ligji i ri për Mbikëqyrjen e Tregut të Produkteve") i cili do të siguronte bazën e nevojshme ligjore për themelimin e një "pike kontakti të produktit" brenda MINT, e cila do të ofrojë informata për rregullat ligjore të vlefshme në Republikën e Kosovës në fushën e pa harmonizuar. Pika e kontaktit të produktit do të themelohet (“e bashkuar” me divizionin e MINT-it që kryen detyra nga neni 31 të Ligjit për Kërkesat Teknike për Produktet dhe Vlerësimin e Konformitetit) në mënyrë që të plotësojë të gjitha kërkesat dhe të kryejë të gjitha detyrat të cilat janë të rregulluara nga dy aktet ligjore të BE-së të përmendura më sipër dhe janë jetike për eliminimin e barrierave të pajustificuara në tregti.

Bazuar në këtë Plan të Veprimit dhe rekomandimin për hartimin e Ligjit të ri, është hartuar Koncept Dokumenti për fushën e mbikëqyrjes së tregut i cili është miratuar me Vendimin Nr.19/89, Dt.09.08.2023 nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Përgatitja e ligjit të ri për inspektimin e përputhshmërisë së produkteve është planifikuar të finalizohet deri në fund të vitit 2024 siç parashikohet në Planin Kombëtar Zhvillimor të Qeverisë.

Për t'u përafuar plotësisht me Rregulloren (BE) 2019/1020, autoriteti rregullator, në këtë rast MINT referuar këtij Koncept Dokumenti ka planifikuar miratimin e një “Ligji të veçantë për Inspektimin e Përputhshmërisë së Produkteve” duke krijuar një qasje koherente dhe harmonizim me Ligjin për Inspektime.

Transpozimi i Rregulloreve të lartcekura në sistemin ligjor të Republikës të Kosovës do të eliminojë mangësitë ligjore ekzistuese në lidhje me fushe veprimtarinë e inspektorateve të cilat inspektojnë produkte industriale jo ushqimore duke krijuar kështu një bazë ligjore horizontale dhe funksionale për mbi shtatëdhjetë (70) fusha të produkteve.

Ligji i ri do të krijojë një mjedis më të përshtatshëm për parandalimin dhe eliminimin e vendosjes së produkteve të papërputhshme në treg, do të ndihmoj autoritetet në luftimin e praktikave të padrejta tregtare, do të mbrojë sigurinë dhe të drejtat e konsumatorëve si dhe do të ketë një impakt të drejtpërdrejtë në ekonominë e vendit. Me ligjin e ri po ashtu do të përmirësohet korniza ligjore në fushën e mbikëqyrjes së tregut të produkteve, si parakusht për përmirësimin dhe modernizimin e funksionimit të lirë të tregut, mbrojtjen e konsumatorit dhe mundësimin e konkurrencës së drejtë.

6. Përgatitjet e autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut për zbatimin e mbikëqyrjes së tregut sipas parimeve dhe dispozitave të Rregullores (BE) 2019/515 për Njohjen Reciproke të Mallrave të Tregtuara Ligjshëm në Një Shtet tjetër Anëtar.

Rregullorja (BE) 2019/515 vendos barrën e provës mbi autoritetet kombëtare të mbikëqyrjes së tregut (inspektoratet) që synojnë të mohojnë qasjen në treg ndaj mallrave që janë vendosur ligjërisht në treg në një shtet tjetër anëtar të BE-së. Ata duhet të paraqesin me shkrim arsyet e sakta teknike ose shkencore për qëllimin e tyre për të mohuar qasjen e produktit në tregun kombëtar. Operatorit ekonomik i jepet mundësia të mbrojë rastin e tij dhe të paraqesë argumente të qëndrueshme tek autoritetet kompetente.

Trajnimet e autoriteteve rregullatore mbi metodologjinë e kontrolleve të detajuara dhe të inspektorateve që zbatojnë rregullat teknike për produktet do të jenë një aktivitet i vazhdueshëm në kuadër të këtij Programi edhe në vitet në vijim.

IV. REKOMANDIME

për Vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës pas diskutimit të raportit vjetor:

1. Raporti Vjetor 2023 i përgatitur sipas “Programit për eliminimin e barrierave në tregti sipas neneve 34 – 36 TFEU (2021 – 2025)” është miratuar.
2. Ministritë kompetente dhe autoritetet e tjera rregullatore, të koordinuara nga MINT, do t'i raportojnë sërish Qeverisë së Republikës së Kosovës deri në fund të Nëntorit 2024 për gjetjet në aktet ligjore të shqyrtuara dhe për afatin kohor të përcaktuar për shqyrtimin e mëtejshëm të detajuar të akteve ligjore të mbuluara nga ky Program si dhe masat korrigjuese të propozuara për heqjen e barrierave të pajustificuara në tregti.
3. Ministritë kompetente dhe autoritetet e tjera rregullatore, gjatë përgatitjes së akteve ligjore të reja ose të ndryshuara në lidhje me tregtinë e produkteve, do të marrin parasysh komentet dhe rekomandimet e dhëna në kuadër të asistencës teknike për shqyrtimin e detajuar të legjislacionit që mund të shkaktojë barriera të pajustificuara në tregti.

4. Shtojca e Raportit të përfshijë edhe një kolonë ku do të përcaktohet afati kohor për eliminimin e barrierës së pajustificuar në tregti.

5. Ministritë kompetente dhe autoritetet e tjera rregullatore janë të obliguara të marrin pjesë rregullisht në të gjitha aktivitetet e Grupit Punues.

6. Forcimi i strukturës të Divizionit të Infrastrukturës së Cilësisë duke u ngritur në nivel Departamenti, me rritjen prej të paktën e tre (3) punonjësve shtesë për të përballuar gjithë përgjegjësitë në kapitullin 1 - Lëvizja e Mirë e Mallrave.

7. Ministritë dhe autoritetet e tjera rregullatore të marrin parasysh rregullisht Vendimet më të fundit të GJED-së mbi nenet 34-36 TFBE dhe më pas në baza tre mujore të kontrollojë dhe t'i raportojë MIET mbi përputhshmërinë e neneve të legjislacionit kombëtar përkatës që rregullon të njëjtën çështje si legjislacioni i vendeve anëtare të BE-së i cili ishte (nga vendimi përkatës i GJED-së) konstatuar se ishte në kundërshtim me nenet 34-36 TFBE.

Për këtë qëllim, QK do t'i ngarkojë MIET-it monitorimin e rregullt të regjistrit përkatës të praktikës gjyqësore të GJED-së dhe njoftimin e menjëhershëm të vendimeve më të fundit tek ministria përkatëse dhe/ose autoritetet rregullatore, të cilat në një periudhë 3 mujore duhet t'i raportojnë MIET-it për shqyrtimin e ekzekutuar të përkatësisë përkatëse. legjislacioni kombëtar dhe rezultati i tij (nëse gjendet një pengesë e ngjashme e pajustificuar ndaj tregtisë, dhe nëse po, afati kohor për ndryshimin ose shfuqizimin e neneve përkatëse kombëtare që përmbajnë MEE ose marrëveshje të ndaluara të shitjes).

Një aktivitet i tillë i vazhdueshëm duhet të raportohet në mënyrë adekuate në raportin vjetor (si aneks i ri) që përmban listën e:

1) rastit të GJED-së të marrë parasysh,

2) legjislacionit përkatës kombëtar të ekzaminuar,

3) ministrisë dhe/ose autoritetit tjetër rregullator përgjegjës

4) rezultatit të shqyrtimi

5) afati kohor për ndërhyrjen legjislative, nëse është e aplikueshme (shfuqizimi ose ndryshimet e neneve përkatëse kombëtare, nëse gjendet pengesë e krahasueshme për tregtinë).

SHTOJCA

Lista e akteve ligjore që është subjekt i shqyrtimit të detajuar kundrejt neneve 34-36 të TFBE-së.